DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT	SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON PRIVATIZATION AGENCY RELATED MATTERS	POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA O PITANJIMA KOJA SE ODNOSE NA KOSOVSKU AGENCIJU ZA PRIVATIZACIJU

AC-I-16-0200

Në ankesën e ***Paditësit/Ankuesit***

1. **M.S.,(pas ardhës i Z.S.)**
2. **Sh.S, (pas ardhës i Z. S)**
3. **H.S,(vëlla i Z. S)**
4. **L.S,(pasardhësi i F.S, i cili është vëllau i Z.S)**
5. **R.S(pasardhësja e F.S, i cili është vëllau i Z. S)**

   të gjithë nga Prizreni

   përfaqësuar nga **Avokat Y.K,**Prizren

kundër

E paditura

KBI "P-E", nga Prizreni

përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit,** rr. 'Ilir Konushefci' nr. 8, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr. sc. Sahit Sylejmani, Kryetar i Dhomës së Posaçme, gjyqtar kryesues, Vladimir Kanev, Werner Kannenberg, Ilmi Bajrami dhe Sabri Halili gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësve të paraqitur kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS, C-III-12-0745 të datës 02 gusht 2016, në seancën vendimmarrëse të mbajtur më 24 nëntor 2016, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1. **Ankesa e paditësve refuzohet si e pabazuar,**

Vërtetohet Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS, C-III-12-0745 i datës 02 gusht 2016.

2. **<u>Rrethanat faktike dhe procedurale:</u>**

Me datë 01 prill 2010, paditësit kanë dorëzuar një padi pronësore në Gjykatën Komunale në Prizren, me të cilën kërkuan nga Gjykata anulimin e Kontratës mbi ndërrimin e paluajtshmërive, leg.nr. 651/66 e vërtetuar pranë Gjykatës Komunale në Prizren. Paditësit në padi po ashtu kërkuan të u njihet e drejta e bashkëpronësisë në ngastrat kadastrale nr. **135, 136**, si dhe 4/5, pjesë ideale të ngastrës kadastrale nr. **138,** të evidentuara sipas fletës poseduese nr. 10 dhe 284, Zona Kadastrale Petrovë (prona kontestuese). Për më tepër në padinë e tyre paditësit pohojnë se paraardhësi i tyre Z. S dhe vëllezërit e tij H. S. e F.S, kanë jetuar në një bashkësi familjare. F. S është paraardhësi i dy paditësive L. S dhe R. S.

Sipas paditësve Z. S ka lidhur një kontratë mbi ndërrimin e patundshmërive me të padituren në bazë së cilës Z.S kishe marrë ngastrën kadastrale nr. **290/1,** ndërsa të padituës i kishte dhënë ngastrat kadastrale **135**, **136** si dhe 4/5 të ngastrës kadastrale nr.**138** (prona e pretenduar). Sipas paditësve kjo kontratë asnjëherë nuk ishte përmbushur. Paditësit kanë pohuar se vazhdimisht i kanë poseduar dhe shfrytëzuar pronat kontestuese, ndërsa asnjëherë nuk e kanë pasur në posedim dhe shfrytëzim pronën kadastrale **290/1**, e cila në bazë të historikut kadastral është evidentuar në regjistrat kadastral si pronë e paraardhësit të tyre Z.S.

Me datë 16 mars 2011, Gjykata Komunale në Prizren me Aktvendimin C.nr. 247/10 e shpallë jokompetencën lëndore për të vendosur lidhur me padinë dhe vendos që lëndën ta referoj për gjykim në DHPGJS.

Me datë 27 prill 2012, lënda e cekur është regjistruar në DHPGJS me numër C-III-12-0745.

Me datë 02 gusht 2016, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së me Aktgjykimin C-III-12-0745, padinë e paditësit H. S. e refuzon për shkak të mungesës së legjitimitetit aktiv në procedurë, ndërsa padia e paditësve lidhur me ngastrat kadastrale **135,** dhe **136/2,** refuzohet për shkak të mungesës së legjitimitetit pasiv të padituës, ndërsa padia lidhur me ngastrat kadastrale nr. **361/1** dhe **138** refuzohet si e pabazuar. Kolegji i Specializuar ka arsyetuar se paditësi H. S nuk është as palë kontraktuese e kontratës mbi ndërrimin e patundshmërive e cila është kërkuar të anulohet, por as trashëgimtar i Z.S në bazë të nenit 73 të LPK-së atij i mungon legjitimiteti aktiv. Tutje Kolegji i Specializuar ka arsyetuar se në bazë të dëshmive të parashtruara kadastrale, ngastrat kadastrale nr. **135** dhe **136/2** nuk janë në pronësi dhe as në posedim të padituës andaj padia lidhur me këto ngastra është refuzuar për shkak se në bazë të nenit 73 të LPK-së i mungon të padituës legjitimiteti pasiv. Padia lidhur me ngastrat kadastrale nr. **136/1** dhe **138** është refuzuar për arsye se Kolegji i Specializuar ka ardhur në përfundim se legjislacioni i Kosovës nuk përfshin një ligj për kthimin e pronave të marra pas Luftës së Dytë Botërore, ndërsa në anën tjetër neni 8a i Ligjit për Transferimin e Pronës së Paluajtshme i vitit 1981 i Republikës së Serbisë, asnjëherë nuk ka qenë i zbatueshëm në Kosovë, i cili është edhe qëndrim ligjor i Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së, kur ka vendosur për disa ankesa në rastet tjera ndaj vendimeve të kolegjeve të specializuara të DHPGJS-së, duke u thirrur në rastin AC-I-13-0114-A0001 i lëshuar me datë 11 dhjetor 2014. Tutje Kolegji i Specializuar ka arsyetuar se Kolegji i Apelit gjithashtu ka marrë qëndrim në rastin e cekur se Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i vitit 1978 nuk ka fuqi prapavepruese për rastet dhe kontratat e lidhura para 1 tetor 1978 kur ka hyrë në fuqi LMD. Kolegji i Specializuar gjithashtu ka arsyetuar se paditësit nga viti 1966 e gjer më 2010 nuk e kanë kundërshtuar validitetin e kontratës edhe pse të njëjtit kanë mundur që këtë ta bëjnë nga viti 1991 e gjer më 1999, bazuar në Ligjin mbi Plotësimin e Ligjit mbi Qarkullimin e Paluajtshmërive. Kolegji i Specializuar gjithashtu ka konstatuar se afatet për të kërkuar anulimin e kontratave të rrëzueshme siç është kjo, tani më

kanë kaluar që nga momenti i parashtrimit të padisë dhe parimi i ligjshmërisë dhe i sigurisë qëndron në kuptim të këtij interpretimi. Në fund Kolegji i Specializuar ka konstatuar se M.Sh.L dhe R.S vepruan në cilësi të pasardhësve tani të ndjerëve Z. S dhe F.S dhe ata e vërtetuan legjitimitetin e tyre aktiv në bazë një kopje të Aktvendimit mbi trashëgiminë dhe të një Njoftimi mbi shqyrtimin e trashëgimisë të lëshuar nga Zyra e noterit, A.M.M.

Me datë 25 gusht 2016, paditësit (në tekstin e mëtejmë ankuesit) parashtruan një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS, C-III-12-0745 të datës 02 gusht 2016, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale , vërtetimit jo të saktë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Ankuesit kërkojnë nga Kolegji i Apelit që ankesa e tyre të aprovohet si e bazuar, Aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të aprovohet padia si e bazuar, ose të prishet Aktgjykimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në rigjykim në Gjykatën e shkallës së parë. Për më tepër në ankesë ankuesit kanë pohuar se prona kontestuese ka qenë e Z.S i cili ka qenë paraardhësi i përbashkët i paditësve dhe në këso raste toka është regjistruar vetëm në emër të një vëllai, megjithëse me vëllezërit e tij të gjithë kanë pranuar se ajo tokë është tokë e përbashkët e tyre. Andaj sipas ankuesve Gjykata nuk do të duhej të refuzonte padinë e paditësit H. S për arsye të mungesës së legjitimitetit aktiv. Tutje në ankesë ankuesit kanë pohuar se ishte bërë një kërkesë Gjykatës që të dilet në vendin e ngjarjes por kjo kërkesë nuk u mor parasysh, andaj sipas tyre kjo ishte edhe arsye që Gjykata ka pasur qasje të gabuar lidhur me realitetin e këtyre tokave. Në ankesë ankuesit po ashtu pohojnë se ngastra kadastrale **290/1** e cila ishte objekt i kontratës së ndërrimit, asnjëherë nuk ishte shfrytëzuar dhe poseduar nga ana e paditësve, andaj sipas tyre kjo marrëdhënie kontraktuese për ndërrimin e pronave nuk ishte e vlefshme dhe nuk ka prodhuar efekte ligjore. Në ankesë ankuesit ende pretendojnë se neni 8a i Ligjit të Serbisë mbi Qarkullimin e Patundshmërive është i zbatueshëm në territorin e Kosovës, ngase sipas tyre Dega civile e Gjykatës Supreme të Kosovës e ka një qëndrim të tillë, dhe është për tu habitur se si Dhoma e Posaçme që është pjesë e Gjykatës Supreme të ketë qëndrim tjetër ligjor.

Me datë 15 shtator 2016, Kolegji i Apelit ka lëshuar Urdhër dhe ankesën e ankuesve ia ka dërguar AKP-së për të dhënë përgjigje në ankesë. AKP-ja Urdhrin e ka pranuar me datë 16 shtator 2016.

Me datë 06 tetor 2016, AKP dorëzon një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës së paditësve. Për më tepër në përgjigjen në ankesë AKP-ja ka kërkuar të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Kolegjit të Specializuar. Në përgjigjen në ankesë AKP pohon se ishte obligim i paditësve ta rregullojnë çështjen e trashëgimisë në kuptim të nenit 171 të Ligjit mbi Procedurën Jokontestimore, gjë që edhe në procedurën ankimore kjo çështje nuk është e rregulluar. AKP-ja në përgjigjen në ankesë pohon se pronat kontestuese nuk figurojnë në emër të paditëses dhe rrjedhimisht në kuptim të kësaj palës së paditur i mungon legjitimiteti pasiv.

Arsyetimi ligjor

Ankesa është e pranueshme por e pabazuar.
Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës sipas nenit 64.1 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-033 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Shtojca).

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Kolegjit të Specializuar është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet vërtetuar.

Baza e kontestit në mes palëve është anulimi i kontratës për ndërrimin e patundshmërive, leg. nr. 651/66, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren si dhe kërkesa e paditësve që t'iu njihet e drejta e bashkëpronësisë në ngastrat kadastrale nr. **135**, **136** dhe të 4/5 të ngastrës kadastrale nr. **138**, të regjistruara në fletën poseduese nr. 10 dhe 284, ZK Petrovë (prona kontestuese e pretenduar).

Paditësit vërtetimin e të drejtës së pronësisë në pronën e pretenduar e kërkojnë mbi bazën e trashëgimisë dhe të posedimit të këtyre pronave.

Pretendimi i paditësve është se paraardhësi i tyre Z. S e ka lidhur një kontratë mbi ndërrimin e patundshmërive me të padituren në vitin 1966, në bazë së cilës kontratë paraardhësi i paditësve Z. Si e kishte marrë ngastrën kadastrale nr. **290/1** ndërsa të padituës ia kishte dhënë ngastrat kadastrale **135**, **136** si dhe 4/5 të ngastrës kadastrale nr. **138**. Pretendimi i paditësve është se Kontrata e cekur nuk është përmbushur pasi që ata asnjëherë nuk e kanë pasur në posedim ngastrën kadastrale **290/1** që paraardhësi i tyre e kishte marrë si ndërrim me ngastrat e cekura.

Paditësit po ashtu pretendojnë se gjatë gjithë kohës, që kur ka ndodhur ndërrimi i patundshmërive me të padituren ishin në posedim dhe shfrytëzim të pronës kontestuese.

Sipas historikut kadastral ngastra nr. **290/1** është e regjistruar në regjistrat kadastral në emër të Z. S i cili është paraardhësi i dy paditësve të parë. Kjo është provë e mjaftuar se shkëmbimi i pronave në bazë të kontratës së ndërrimit ka ndodhur.

Ngastrat kadastrale nr. **135** dhe **136/2**, në bazë të certifikatave pronësore të cilat i ka dërguar AKP-ja në Gjykatë nuk janë në pronësi dhe as në posedim të NSH-së së paditur por në emër të personave të tretë.

Paditësi H. S nuk ishte palë e Kontratës mbi ndërrimin e patundshmërive dhe as trashëgimtar i të ndjerit Z. S.

Në këto rrethana të këtij rasti është e qartë se ishte i saktë vendimi i Kolegjit të Specializuar kur padinë e paditësit H.S e kishte refuzuar për shkak të mungesës së legjitimitetit aktiv të tij. Gjithashtu i saktë është edhe vendimi i Kolegjit të Specializuar kur padinë për ngastrat kadastrale nr. **135** dhe **136/2**, e kishte

refuzuar, pasi që në bazë certifikatave pronësore është vërtetuar se ato ngastra në regjistrat kadastral nuk evidentohen më në emër të padituës, por në emër të personave të tretë, andaj për këto ngastra kadastrale ka munguar legjitimiteti pasiv i të padituës.

Ndërsa sa i përket ngastrave kadastrale nr. **136/1** dhe **138** është vërtetuar se ato në regjistrat kadastral janë ende në emër të NSH-së së paditur, mirëpo këto prona të pretenduara nga paditësit nuk mund të kthehen pasi që mungon baza ligjore për kthimin e tyre.
Kolegji i Apelit vëren se Kolegji i Specializuar saktë ka konstatuar se në Kosovë ende nuk ka ligj për kthimin e pronave të marra pas Luftës së Dytë Botërore, ndërsa gjithashtu i saktë është konstatimi i Kolegjit të specializuar se neni 8a i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit mbi Qarkullimin e Patundshmërive i Republikës së Serbisë, si dhe Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i vitit 1978, nuk mund të zbatohen në këtë rast. Arsyet ligjore për pamundësinë e zbatimit të këtyre dispozitave ligjore, siç ka konstatuar Kolegji i Specializuar, tashmë janë dhënë nga Kolegji i Apelit në disa raste të tilla.

Andaj nga këto arsye padia e paditësve lidhur me ngastrat **136/1** dhe **138** nuk ka bazë ligjore të aprovohet dhe saktë ajo është refuzuar si e pabazuar.

Kolegji i Apelit konstaton se në bazë të Aktvendimit mbi Trashëgiminë i cili është në dosje, paditësit M. dhe Sh.S ishin pasardhësit e Z. S., andaj ata kishin vërtetuar legjitimitetin e tyre aktiv në procedurë. Ndërsa paditësit R. S dhe L. S në bazë të Njoftimit noterial të lëshuar nga Zyra e Noterit ata janë trashëgimtar të F. S, mirëpo ky dokument i lëshuar noterial nuk zëvendëson Aktvendimin mbi trashëgiminë i cili është i vetmi dokument në bazë të nenit 171 të Ligjit për Procedurën Jashtëkontestimore me të cilin mund të vërtetohet legjitimiteti aktiv i palës në procedurë.

Andaj nga këto arsye Kolegji i Apelit vlerëson se paditësit L. S dhe R. S nuk kanë legjitimitet aktiv në procedurë. Rrjedhimisht padia e tyre duhet të refuzohet

përveç arsyeve të lartë cekura edhe mbi bazën e mungesës së legjitimitetit aktiv të tyre të cilët kanë dështuar ta vërtetojnë në procedurën pranë Gjykatës së shkallës së parë.

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 10.10 të LDHP është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Vendosur nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 24 nëntor2016.

Taksat gjyqësore

Ndaj ankuesve nuk do të caktohen taksë gjyqësore meqë tashmë ata e kanë paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore në shumë prej 100 euro, me datë 20 shtator 2016.

Mr. sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues _____